Kronikë

Fushë Krujë/ Gjendet një makinë e djegur në Tapizë, brenda saj zbulohen dy automatikë! Një nga pistat e hetimit, vrasja 65-vjeçarit në Lezhë

Deri më tani 2 pista po hetohen. E para, hetuesit kanë dyshime se makina mund të ketë lidhje me vrasjen e 65-vjeçarit Gjergj Tusha në Pllanë të Lezhës. Pista e dytë që po verifikohet është parandalimi i mundshëm i një atentati tjetër.

Sokol Dema
4 Tetor, 09:13 | **Përditesimi: 4 Tetor, 10:48**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Një automjet i djegur brenda të cilës u konstatuan dy armë zjarri është gjetur pranë një impianti të përpunimit të inerteve në zonën e Tapizës në Fushë-Krujë.

Automjeti është zbuluar nga policia rreth orës 21:30 të së premtes (3 tetor). Nga konstatimi brenda mjetit u gjendën edhe dy armë zjarri automatike dhe një krehër.

Policia ende e ka të paqartë dinamikën e djegies së makinës "Peugeut", ndërsa po këqyren pamjet e kamerave të sigurisë për të verifikuar rastin. Deri më tani 2 pista po hetohen. E para, hetuesit kanë dyshime se makina mund të ketë lidhje me vrasjen e 65-vjeçarit Gjergj Tusha në Pllanë të Lezhës, por mbetet pistë jo e plotë, pasi 2 ngjarjet kanë distancë kohore me njëra-tjetrën.

LEXO EDHE:
Ben Andoni: Zemërimi si frymëzim i munguar te PD

Vrasja dyshohet të jetë bërë rreth orës 17:00, ndërsa makina me targa të huaja "Peugeot" u gjet duke u djegur rreth orës 21:30.

Pista e dytë që po verifikohet është parandalimi i mundshëm i një atentati tjetër. Për shkak të vrasjes në Lezhës, ka pasur patrullim të shtuar të policisë, më shumë se zakonisht, në kërkim të lëvizjeve të mundshme të autorëve. Kjo, sipas burimeve, mund të ketë ndikuar për parandalimin e ndonjë atentati tjetër. Ndërkohë blutë kanë kontrolluar mirë zonën dhe deri më tani nuk rezulton të ketë një ngjarje tjetër.

"Rreth orës 21:30, në afërsi të një impianti për përpunimin e inerteve, në Tapizë, është djegur plotësisht një automjet tip "Peugeot". Gjatë këqyrjes, në brendësi të tij janë gjetur dy armë zjarri automatike dhe një krehër. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve, si dhe për sqarimin e rrethanave të rastit", njofton Policia e Tiranës.

Grupi hetimor po punon për të sqaruar ngjarjen si dhe për të zbuluar nëse armët dhe automjeti janë përdorur në ndonjë ngjarje kriminale.

lajm ne perditesim...

V.GJ /r.k./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | arme zjarri | makine e djegur | fushe kruje

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 4 Tetor, 20:56

PD pritet të mbështesë kandidatë të pavarur në 6 Bashki, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Tiranë/ Protestë pro Gazës në sheshin 'Skënderbej', tubuesit shfaqen me flamuj të Palestinës (VIDEO)
4 Tetor, 17:30

Goditën policin dhe më pas thyen kamerat e sigurisë në Komisariat, arrestohen dy të rinjtë në Tiranë
4 Tetor, 17:13

Miqësorja kundër San Marinos, Bushi: Për ne është si një ndeshje Evropiani, i kënaqur me grupin e futbollistëve që kam
4 Tetor, 15:23

Humbja në derbi sjell pasoja, dorëhiqet drejtori sportiv i Partizanit! Abilaliaj: Kam dhënë gjithçka
4 Tetor, 13:35

Tiranë/ Prezantohej si punonjës i forcave speciale të Policisë, arrestohet 43-vjeçari! Në pranga edhe një tjetër
4 Tetor, 13:11

Tiranë/ Zbulohet Call-Centeri që mashtronte qytetarët e BE-së, pranga administratorit dhe bashkëpunëtorit. Sekuestrohen mbi 106 mijë euro (EMRAT + VIDEO)
4 Tetor, 10:51

Fier/ Me armë me vete në makinë dhe nuk iu bindën Policisë për të ndaluar, arrestohen 2 persona! (EMRAT+VIDEO)
4 Tetor, 10:23

Tiranë/ Vodhi çantën me 14 mijë euro në një lokal, pranga 65-vjeçarit (EMRI+VIDEO)
4 Tetor, 09:41

'Boll u tallët me emra leshi', Murrizi: Deklaroni publikisht që PD e ka mbyllur 'dyqanin'
3 Tetor, 20:44

Kujtim Gjuzi për Report Tv: Presidenti shkeli Kushtetutën me dekretin për zgjedhje në Tiranë! Nëse do futem në garë, e kam të fituar
3 Tetor, 19:46



Humbi për 1 votë mandatin në Kushtetuese, Naureda Llagami i kërkon Gjykatës Administrative të pezullojë vendimin e Gjykatës së Lartë

Keti Banushi

3 Tetor, 18:46

Begaj shpalli zgjedhje në Tiranë/ Romeo Kara për Report Tv: Vendi në bashki s'është vakant, GJK të pezullojë dekretin! Alesia Balliu: PD do dalë e humbur
3 Tetor, 18:22

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje